



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

HARTA RRUGORE E ASK-së PËR VITIN 2013

**Janar 2013
Prishtinë**

PARATHËNJE

Ky dokument përmbanë planin operacional të Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe është i bazuar në Planin Vjetor të Statistikave Zyrtare për 2013 të ASK-së, si dhe në Programin 5 vjeçar të Statistikave i cili është aprovuar nga Qeveria e Kosovës.

Në vitin 2013 ASK do të jetë e përqendruar në zbatimin e Programit Vjetor të Statistikave Zyrtare 2013, pastaj në zbatimin e Programit 5 vjeçar të Statistikave, dhe me zbatimin e Rregullorës për Riorganizimin e ASK-së, themelimin e Departamentit të politikave, planifikimit, koordinimit dhe komunikimit. Pasi Qeveria e Kosovës tashmë ka aprovuar Rregullorën për ristrukturimin e ASK-së, një kohë të konsiderueshme do të marrë realizimi i tij, duke patur parasysh ndikimin e këtij ristrukturimi në të gjitha departamentet e ASK-së.

Ashtu siç tregon edhe titulli, ky dokument paraqet aktivitetet më të rëndësishme të ASK-së dhe është i bazuar në planet dhe detyrat e rregullta të paraqitura në formë të agreguar (përgjithësuar), përderisa planet më të detajizuara ekzistojnë në dokumentet e brendshme të departamenteve përkatëse të ASK-së.

Në fund të vitit 2013, ASK do të përgatisë një raport vjetor i cili mbështetet në krahasimin e arritjeve që janë planifikuar në këtë dokument dhe do të adresojë divergjencat në koordinim me Zyrën e Kryeminsitrit dhe me të gjitha palët tjera të interesuara.

PËRMBAJTJE

1. ORGANIZIMI i ASK-së	4
1.1. Aktivitete te rëndësishme që priten të finalizohen në 2013	4
2. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONALIZIMI I KËSHILLIT.....	5
3. ZHVILLIMI I DEPARTAMENTEVE SIPAS PLANIT VJETOR 2013.....	5
3.1. Departamenti i Administratës	5
3.2. Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim.....	6
3.3. Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve.....	6
3.4. Departamenti i Statistikave Ekonomike.....	7
3.5. Departamenti i Statistikave Sociale	10
3.6. Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit	12
3.7. Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative	13
4. FUSHAT E MBËSHTETURA NGA DONATORËT.....	14
5. SFIDAT	15
6. SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE & QASJA.....	15
7. BUXHETI	19
Aneksi 1 Organogrami i ASK nga muaj Janar 2013	20

1. ORGANIZIMI I ASK-së

ASK ka dorëzuar për aprovim propozimin për riorganizimin e ASK-së në Qeveri e Kosovës, Rregullore e cila është aprovuar dhe me zbatimin e sajë, pritet të ndryshojë në mënyrë substanciale rregullimi ekzistues i ASK-së. Struktura e re e propozuar është bashkëngjitur në këtë dokument si Aneks.

Me aprovimin e Ligjit mbi statistikat zyrtare, para ASK-së shtrohen detyra dhe përgjegjësi të mëdha në ngritjen edhe zhvillimin e statistikave zyrtare në nivel vendi në harmoni me rekomandimet dhe standardet ndërkombëtare statistikore.

Prandaj si rezultat i Ligjit të lartëcekur, ASK-ja ka përgjegjësi të përgjithshme në prodhimin e statistikave zyrtare dhe për çështje të tjera që parashihen me ligj dhe me aktet nënligjore.

Si rrjedhojë e kësaj gjatë vitit 2013, ASK-ja planifikon:

- Përcaktimin dhe zhvillimin e metodologjisë statistikore, klasifikimin dhe përdorimin e standardeve për prodhimin e statistikave zyrtare. Për të gjitha publikimet e dala nga ASK-ja do të zbatohen të gjitha metodologjitë dhe standardet e statistikave evropiane.
- Ti paraqesë, përmes Kryeministrit, për miratim Qeverisë dhe Kuvendit raportin mbi zbatimin e planit, programit dhe shfrytëzimin e mjeteve buxhetore. Raporti vjetor i miratuar publikohet.
- Bashkëpunimi me organizatat vendore dhe ndërkombëtare kompetente për statistikat zyrtare, për të mundësuar krahasimin e statistikave zyrtare me statistikat e prodhuara në sisteme të tjera statistikore. Bashkëpunimi statistikor me organizatat ndërkombëtare me pjesëmarrjen e stafit të ASK-së në takime, workshope dhe seminare në fusha të ndryshme statistikore, si dhe me ekspertët ndërkombëtar në ASK.

1.1 Aktivitete të rëndësishme që priten të finalizohen në 2013

- Përgatitja e projektit për rritjen e kapaciteteve në ASK (njerëzore dhe infrastrukturore) dhe fuqizimi i statistikave ekonomike.
- Prodhimi i statistikave sipas standardeve evropiane dhe botërore dhe zgjerimi i volumit të tyre- pjesëmarrja në takime ndërkombëtare, implementimi i metodologjisë statistikore evropiane.
- Fillimin e zbatimit të kornizës së vlerësimit të performancës të PVSZ.
- Përgatitja dhe publikimi i trembëdhjetë publikimeve të reja nga rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2011.
- Fillimi i realizimit të projektit të Regjistrimit të Bujqësisë-projekt që do të realizohet në kuadër të IPA 2012 dhe IPA 2013 me pjesëmarrje të donatorëve të tjerë dhe participim të Qeverisë së Kosovës;

- Sigurimi i buxhetit të nevojshëm nga buxheti i Kosovës dhe nga donatorët për vitin 2013 – ASK ka kodin e vet buxhetor ku sipas plan programit bëhet edhe aprovimi i buxhetit për ASK, ndërsa nga donatorët bëhet mbështetja përmes projekteve të ndryshme.

2. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONALIZIMI I KËSHILLIT STATISTIKOR

Këshilli përbëhet nga dymbëdhjetë (12) anëtarë dhe Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, që përfaqësojnë ministrinë kyçe, bankën qendrore, administratën tatimore, universitetet, komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile siç janë cekuar më poshtë:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Ministria e Shëndetësisë
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
- Ministria e Financave
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
- Universiteti i Prishtinës
- Administrata Tatimore
- Zyra e Planifikimit Strategjik pranë Zyrës së Kryeministrit
- Aleanca e Kosovare e Bizneseve
- Instituti për Menaxhimin e Ndërmarrjeve dhe Inxhinieri (IMNI)

Këshilli do të jep rekomandime mbi përgatitjen dhe realizimin e Programit të Statistikave Zyrtare sidhe mbi zhvillimin dhe funksionimin e gjithëmbarshtëm të ASK-së.

Këshilli është themeluar me Vendim të Kryeministrit dhe do të funksionojë në mbështetje të rregullores së miratuar konform ligjit të statistikave zyrtare.

3. ZHVILLIMI I DEPARTAMENTEVE SIPAS PLANIT VJETOR 2013

Ky zhvillim parashihet me ofrimin e ndihmës profesionale për të evituar interpretimin e gabueshëm të të dhënave të ofruara nga statistikat zyrtare. Gjithashtu edhe me zbatimin e standardeve dhe metodologjive të EUROSTAT-it të kërkuara sipas politikave të disiminimit për evitimin e të gjitha gabimeve të mundshme për të gjitha publikimet e ASK-së, zhvillimi mëtejshëm i metodologjisë dhe teknologjisë statistikore; zhvillimi i politikave të standardizimit dhe mbështetja me ekspert ndërkombëtarë për implementimin e këtyre standardeve. Më poshtë janë dhënë zhvillimet e parapara sipas departamenteve në vitin 2013.

3.1. Departamenti i Administratës

Departamenti do të jetë përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të administratës në ASK përfshirë: shërbimet financiare, kontrollin buxhetor dhe mbështetje për menaxhimin e buxhetit; shërbime të personelit, duke mbuluar mirëqenien, rekrutimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore; dhe prokurimin dhe shërbimet për menaxhimin e kontratave (menaxhimi i aseteve, pronës dhe shërbimet e logjistikës). Në kuadër të departamentit të

administratës, sipas planit të ri të organizimit, do të jenë të angazhuar një drejtor dhe 14 zyrtarë.

Një prej pikave kyçe të fokusit të këtij departamenti do të jetë riorganizimi dhe rekrutimi i pesë personave për postet e reja të aprovuara nga Parlamenti si dhe plotësimi me staf i pozitive ekzistuese të lira në ASK në mënyrë që të arrihet kompletimi i personelit të ASK-së brenda limiteve të lejuara.

3.2. Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim

Me planin e riorganizimit parashihet krijimi i një departamenti të ri në ASK: Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim. Në këtë departament numri i stafit do të përbëhet nga katër persona me një Drejtor, i cili do të jetë shërbejë edhe si zëvendës i Kryeshefit Ekzekutiv (KE) të ASK-së. Ky Departament do të jetë përgjegjës për përmirësimin e bashkëpunimit (me institucionet vendore dhe ndërkombëtare), koordinimin (brenda ASK-së dhe Sistemit Statistikor të Kosovës), zhvillimin dhe zbatimin e politikave si dhe monitorimin e prodhimit të statistikave zyrtare. Po ashtu ky departament do të ketë rol qendror në monitorimin dhe implementimin e programit 5 vjeçar statistikor.

Parashihet që Drejtori i departamentit do të zëvendësojë KE-në sa herë që kërkohet një gjë e tillë. Departamenti do të ofrojë këshilla ligjore për ASK-në dhe Sistemin më të gjerë Statistikor të Kosovës dhe për palët të tjera të interesuara sipas nevojës.

Ky departament duhet të paraqesë të dhëna te Këshilli i Sekretarëve të Përgjithshëm brenda zyrës së Kryeministrit përmes Zyrës së Planifikimit Strategjik me qëllim të arritjes së planifikimit më të mirë në Qeveri.

3.3. Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve

Departamenti i regjistrimeve dhe anketimeve, si departament i ri në ASK, do të jetë përgjegjës për dizajnimin, zbatimin dhe organizimin e regjistrimeve dhe anketave sociale, ekonomike dhe bujqësore në ASK. Ky departament parashihet të ketë dy divizione: divizionin e regjistrimit dhe divizionin e anketimeve. Departamenti i ri do të ketë nën ombrellën e vet edhe zyrat regjionale të ASK-së. Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve do të ketë rolin e menaxhimit dhe mbikqyrjes së aktiviteteve operative të zyrave regjionale të ASK-së në aspektin e mbledhjes së të dhënave.

Regjistrimi i Popullsisë në Kosovë i vitit 2011 ka përfunduar me sukses dhe në shtator 2012 është bërë shpallja e rezultateve finale. Deri më tani janë botuar këto publikime:

- Të dhënat kryesore
- Njerëz në lëvizje: analizë e mobilitetit ndërkombëtar, kombëtar dhe lokal të qytetarëve të Kosovës
- Raporti për Metadat
- Raporti i cilësisë
- Kushtet dhe organizimi i jetesës
- Vlerësimi i rezultateve të regjistrimit me anë të anketës së pas-regjistrimit

Në vitin 2013 parashihet publikimi i 13 botimeve tjera lidhur me rezultatet e regjistrimit të popullsisë.

Lista e botimeve të planifikuara të regjistrimit të popullsisë për vitin 2013

Muaji i botimit	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nen	Dhj
Vlerësimi i Popullsisë	31		28									
Të dhënat kryesore mbi vendbanimet e Kosovës				16								
Të dhënat kryesore demografike				25								
Të dhënat kryesore socio-ekonomike					9							
Të dhënat kryesore të Tregut të Punës					14							
Të dhënat kryesore të Bujqësisë						6						
Të dhënat kryesore të ekonomive familjare							11					
Të dhënat kryesore të Arsimit									4			
Të dhënat kryesore të ndërtesave dhe Banesave/Shtëpive									26			
Atlasi Statistikor										25		
Të dhënat kryesore të Migrimit (Emigrim-Imigrim)											22	
Projeksionet Demografike												20

Vëreni se data e shkruar në kutinë e hijëzuar paraqet datën e publikimit

3.4. Departamenti i Statistikave Ekonomike

Tri divizione do të ekzistojnë në kuadër të këtij departamenti: divizioni i llogarive kombëtare, i statistikave të çmimeve dhe divizioni i ndërmarrjeve dhe tregtisë me jashtë.

Përmirësimi i cilësisë së regjistrimit të bizneseve, kalimi në kalsifikimin e NACE 2, fillimi i projektit IPA dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i treguesve të inflacionit dhe statistikave ekonomike bashkë me statistikave të tregtisë së jashtme janë në epiqendër të programit për vitin 2013. Po ashtu synohet përmirësimi i cilësisë dhe përafrimi me standardet dhe metodologjitë e Eurostatit. Shkurtimi i afateve të publikimeve të të dhënave.

Më poshtë është lista e publikimeve të pritura në Departamentin e Statistikave Ekonomike në vitin 2013

Muaji i botimit	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Statistikat e tregtisë së Jashtme	Nën 2012	Dhj 2012	Jan 2013	Shk 2013	Mar 2013	Pri 2013 & 2012	Maj 2013	Qer 2013	Kor 2013	Gus 2013	Sht 2013	Tet 2013
Indeksi i çmimeve të Konsumit	Dhj 2012	Jan 2013	Shk 2013	Mar 2013	Pri 2013	Maj 2013 & 2012	Qer 2013	Kor 2013	Gus 2013	Sht 2013	Tet 2013	Nën 2013
Statistikat e Hotelarisë			TM4 /2012			TM1 /2013			TM2 /2013			TM3 /2013
Indeksi i çmimit të importit			TM4 /2012			TM1 /2013			TM2 /2013			TM3 /2013
Bilanci i Energjisë në Kosovë			TM4 /2012			TM1 /2013			TM2 /2013			TM3 /2013
Indeksi i çmimeve të prodhimit			TM4 /2012			TM1 /2013			TM2 /2013			TM3 /2013
Rep.stat mbi ndërmarrjet në Kosovë		TM4 /2012			TM1 /2013			TM2 /2013			TM3 /2013	
Statistikat e Transportit		TM4 /2012			TM1 /2013			TM2 /2013			TM3 /2013	
Llogarit Qeveritare						2012						
Bruto produkti vendor BVP-Qasja e shpenzimeve									2012			
Rezultatet e Anketes Strukturore te ndërmarrjeve												2012
Bruto produkti vendor BVP-Qasja e Prodhimit												2012

Vëreni se muaji i shkruar ne kutinë e hijëzuar paraqet muajin/vitin e raportuar përdërisa muaji në krye te tabelës është muaji ne te cilin publikimet priten të shpërndahen

Gjatë vitit 2013 planifikohen të realizohen këto aktivitete sa i përket statistikave makroekonomike:

Aktivitetet tjera

a) Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve 2012

- Anketimi i ndërmarrjeve te zgjedhura (mostra) Prill-Qershor 2013

- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave Maj -Shtator 2012
 - Përgatitja e të dhënave përfundimtare për BPV Tetor 2013
 - Publikimi i të dhënave Dhjetor 2013
- b) Anketa Tremujore e ndërmarrjeve TM4 /2012,
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Janar - Mars 2013
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave Prill 2013
- c) Anketa Tremujore e ndërmarrjeve TM1 /2013,
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Maj -Qershor 2013
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave, Qershor – Korrik 2012
- d) Anketa Tremujore e ndërmarrjeve TM2 /2013
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Korrik - Shtator 2013
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave, Shtator – Tetor 2013
- e) Anketa Tremujore e ndërmarrjeve TM3/2013
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Tetor –Dhjetor 2013
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave, Dhjetor 2013
- f) Anketa për Çmimet e kostos së ndërtimit TM4 /2012,
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Janar - Mars 2013
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave Prill 2013
- g) Anketa për Çmimet e kostos së ndërtimit TM1 /2013,
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Maj -Qershor 2013
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave, Qershor – Korrik 2012
- h) Anketa për Çmimet e kostos së ndërtimit TM2 /2013
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Korrik - Shtator 2013
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave, Shtator – Tetor 2013
- i) Anketa për Çmimet e kostos së ndërtimit TM3/2013
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Tetor –Dhjetor 2013
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave, Dhjetor 2013
- j) Kalimi në klasifikimin e NACE 2, Implementimi i aktiviteteve të parapara:
- Anketa testuese dhe kodimi (përfunduar në tetor 2012)
 - Realizimi i anketës në terren (deri në mars 2013)
 - Kodimi (Maj 2013)
 - Përfshirja e të dhënave (Qershor 2013)
 - Raporti i përgjithshëm
- k) Projekte të IPA 2011 (MB)* -Programi i bashkëpunimit statistikor me shumëpërfitues IPA 2011
- l) Pariteti i Fuqisë Blerëse

- m) Metodologjia e Llogarive Kombëtare PP1
- n) Llogaritë Kombëtare tremujore PP2
- o) Statistikat e tregtisë së jashtme për mallra
- p) Indeksi i harmonizuar i Çmimeve të Konsumit
- q) Regjistri Statistikor i Bizneseve dhe
- r) Statistikat Strukturore të ndërmarrjeve

/* Dinamika e realizimit të projekteve të IPA 2011 është sipas kontratës së nënshkruar, deri në vitin 2014.

3.5. Departamenti i Statistikave Sociale

Me planin e ri të riorganizimit të ASK-së, parashihet që departamenti i popullsisë të shrihet në Departamentin e Statistikave Sociale. Ky departament do të përbëhet nga divizioni i statistikave sociale dhe divizioni i statistikave të popullsisë. Stafi i Departamentit të statistikave sociale ka 1 drejtor, 2 shefa të divizioneve dhe 19 zyrtarë.

Lista e publikimeve të pritura në Departamentin e Statistikave Sociale në vitin 2013

Muaji i botimit	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare					2012						
Anketa e Fuqisë Punëtore				2012							
Statistikat e Jurisprudencës, për personat e madhor					2012						
Statistikat e Arsimit										2012/ 2013	
Statistikat e Arsimit për parashkollor (3-6 vjeç)						2012/ 2013					
Statistikat e Arsimit për arsimin fillor (6 -11 vjeç)					2012 /2013						
Statistikat për ars. e ulët dhe të mes. të lartë (15 -19 vjeç)							2012 /2013				

Statistikat e Arsimit Universitar								2012 /2013			
Statistikat e Varfërisë		2011									
Statistikat e Jurispodencës për persona të mitur								2012			
Statistikat e Kulturës									2012		
Statistikat e Mirëqenies sociale	2012			TM1 /2013			TM2 /2013		TM3 /2013		
Statistikat e Shëndetësisë										2012	
Statistikat e sportit										2012	
Lindjet ne Kosove				2012							
Vdekjet ne Kosove					2012						
Kurorëzimet dhe shkurorëzimet ne Kosove					2012						
Gratë dhe Burrat në Kosovë		2010-2011									
Shkaqet e Vdekjeve ne Kosove											2012

Vëreni se muaji i shkruar në kutinë e hijezuar paraqet muajin e raportuar të botimit përdërisa muaji në krye të tabelës është muaji në të cilin publikimet priten të shpërndahen

Aktivitetet tjera

- Publikimi i botimit “Statistikat e varfërisë 2011”, Mars 2013. Ky aktivitet është rezultat i bashkëpunimit me Bankën Botërore.
- Zhvillimi i Anketës së Grupimeve të Indikatorëve të Shumefishtë (MICS5) në bashkëpunim me UNICEF-in.
- Vazhdimi i punës lidhur me iniciativën rajonale të mbledhjes së të dhënave për indikatorët kryesor rreth fëmijëve dhe femrave (TransMonEE)-në bashkëpunim me UNICEF.
- Digjitalizimi i Regjistrimit Demografik-vazhdon bashkëpunimin me Agjencionin e Regjistrimit Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) si udhëheqës të projektit për digjitalizimin e regjistrit të gjendjes civile.

- e) Zhvillimi i anketës për persona me aftësi të kufizuara. Realizimi i këtij projekti do të varet nëse arrihet të sigurohet mbështetja financiare nga Zyra e Qeverisjes së Mirë pranë Kryeministrit.
- f) Krijimi i bazës së të dhënave në ASK për migrimet/imigrimet në bashkëpunim me MPB të Kosovës.
- g) Publikimi i të dhënave mbi Remitancat 2012/2013 në Kosovë, publikimi i të dhënave, qershor, 2013. Projekt i mbështetur nga UNDP.
- h) Publikimi i të dhënave mbi Korrupsionin dhe Krimin ndaj Bizneseve, publikimi i të dhënave, shkurt, 2013. Projekt i mbështetur nga UNODC.
- i) Publikimi i “Hulumtimi mbi keq shfrytëzimin e fëmijëve”. Hulumtimi mbi keq shfrytëzimin e fëmijëve në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), parashihet të zhvillohet në vitin 2013 nëse MPMS ia alokon buxhetin ASK-së për zhvillimin e këtij hulumtimi.

3.6. Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit

Bazuar në planin e riorganizimit të ASK-së, departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit ka dy divizione në kuadër të saj: divizioni i statistikave të bujqësisë dhe ai i statistikave të mjedisit. Si edhe në vitin e shkuar, departamenti i bujqësisë dhe mjedisit do të vazhdojnë nxjerrjen e botimeve të rregullta të parapara në kalendarin e botimeve 2013. Prioritet e departamentit për vitin 2013 do të jenë dhe regjistrimi i bujqësisë, harmonizimi me standarde dhe me metodologjitë e Eurostatit, përmasimi i kualitetit të këtyre statistikave dhe shkurtimi i kohës së prodhimit të statistikave.

Më poshtë është lista e publikimeve të pritura në Departamentin e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit në vitin 2013

Muaji i botimit	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Indeksi i çmimeve të prodhimeve dhe çmimet në Bujqësi	2005-2012 TM4/ 2012			TM1/ 2013			TM2/ 2013			TM3/ 2013	
Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi	2005-2012 & TM4/ 2012			TM1/ 2013			TM1/ 2013			TM3/ 2013	
Anketa e mbeturinave industriale											2012
Anketa e mbeturinave komunale											2012
Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore					2012						

Vëreni se muaji i shkruar ne kutinë e hijezuar paraqet muajin e raportuar përderisa muaji në krye të tabelës paraqet muajin në të cilin publikimet priten të shpërndahen

Me aprovimin e Ligjit për regjistrimin e bujqësisë nga Parlamenti i Kosovës në dhjetor të vitit 2012, Departamenti i bujqësisë dhe mjedisit si prioritet në vitin 2013 ka realizimin e regjistrimit të bujqësisë. Ky regjistrim kryhet nga ASK në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR).

Procesi i regjistrimit te bujqësisë në vitin 2012:

- Është kryer futja e te dhënave ne databazë (dhjetor 2012).
- Janë kryer parapërgatitjet për regjistrimin pilot të bujqësisë si: përgatitja e pyetësorit dhe udhëzuesit, janë trajnuar regjistruesit si dhe stafi tjetër dhe është kryer regjistrimi pilot i bujqësisë (faza e grumbullimit te te dhënave) në Nëntor 2012.

Aktivitetet e mëtutjeshme në vitin 2013:

1. Realizmi i regjistrimit të bujqësisë

- analiza dhe nxjerrja e konkluzioneve nga regjistrimi pilot i bujqësisë (janar–shkurt 2013)
- krijimi i planit të detajuar të aktiviteteve të regjistrimit të bujqësisë (shkurt –mars 2013)
- parapërgatitjet tjera për fillimin e regjistrimit të bujqësisë
- realizimi i regjistrimit të bujqësisë (nëntor 2013)
- realizimi i anketës post- regjistruese të bujqësisë

2. Publikimi i botimit “Llogaritë ekonomike në bujqësi 2010-2011”. Edhe pse ky publikim nuk është parapar në kalendarin e rregullt të publikimeve, mund të realizohet në rast se do të ekzistojë mbështetja nga SIDA/SCB për praktikantët në ASK të cilët janë të angazhuar në këtë botim.

3.7 Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative

Departamenti i Metodologjisë dhe TI ka dy divizione sipas planit të riorganizimit: divizioni i metodologjisë dhe diseminimit dhe divizioni i teknologjisë informative.

Në kuadër të divizionit të TI, planifikohet që të punësohen dy persona shtesë të fushës së TI. Gjithashtu, pritët që në kuadër të këtij divizioni të angazhohet një ekspertë ndërkombëtar nga fusha e TI-së si pjesë e mbështetjes nga UNDP për sistemin e TI të ASK-së.

Qëllimi i ASK-së për vitet e ardhshme do të jetë krijimi i një Sistemi unik statistikor të TI-së, të zbatueshëm për të gjitha departamentet e stasisitkave prodhuese. Sfidat në realizimin e këtij plani janë kapacitetet dhe mundësitë e stafit të ri të divizionit të TI për të plotësuar të gjitha nevojat e sistemit të TI në ASK. Planet e ASK-së për tejkalimin e kësaj sfide janë ngritja e mëtutjeshme e kapacitete humane përmes trajnimeve afatgjate dhe mbështetja e ASK-së nga ekspertët e jashtëm.

Aktivitetet shtesë në vitin 2013 për departamentin e metodologjisë dhe TI:

- Vjetari Statistikor i ASK-së, i cili planifikohet të botohet gjatë muajve të parë të vitit 2013
- Vlerësimi i sistemit të TI në ASK dhe nxjerrja e raportit me rekomandime nga konsulenti i TI-projekt i mbështetur nga UNDP (Janar- Mars 2013).
- Departamenti i Metodologjisë dhe TI të ofrojë raport në baza mujore për drejtorët e gjitha departamenteve dhe për Kryeshefin e ASK-së për numrin e klikimeve të botimeve nga shfrytëzuesit e jashtëm.

Më poshtë është lista e publikimeve të pritura në Departamentin e Metodologjisë dhe TI në vitin 2013

Muaji i botimit	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Kosova në shifra					2012							
Buletini tremujor	Tet-Dhj 2012			Jan-Mar 2013			Pri-Qer 2013			Kor-Sht 2013		
Atllasi statistikor										2011		
Fletë palosja e ASK-së												2012
Kalendari i botimeve të ASK											2014	
Kalendari vjetor i ASK-së												2013
Katalogu i publikimeve të ASK 2011												2012

Vëreni se muaji i shkruar në kutinë e hijezuar paraqet muajin e raportuar përderisa muaji në krye të tabelës paraqet muajin në të cilin publikimet priten të shpërndahen

4. FUSHAT E MBËSHTETURA NGA DONATORËT

Fondet e EU-së dhe SIDA do të vazhdojnë të mbështesin ASK-në si donatorë kryesor. Donatorë tjerë të rëndësishëm janë FMN, Banka Botërore, UNFPA , UNICEF, UNDP etj.

IPA 2011- programi regional shumpërfitues do të vazhdojë të mbështes ASK-në në 13 pilot projekte, si dhe do të mbështes stafin e ASK-së për pjesmarrje në takimet, konferencat, trajnimet, punëtoritë, grupet e punës që do të inkorporohen në instrumentin planifikues të aktiviteteve Mc-list nga Eurostat për vitin 2013.

IPA 2012 do të mbështesë zhvillimin e statistikave ekonomike. SIDA/SCB-do të mbështesë forcimin e kapaciteteve statistikore në ASK për një periudhë katër vjeçare.

UNICEF do të mbështesë statistikat sociale duke mbështetur realizimin e anketës së MICS5 (anketa e grupimeve të indikatorëve të shumëfishtë) dhe rritjen e kapaciteteve, duke shtuar një staf dhe një konsulentë si asistencë.

UNDP do të mbështesë zhvillimin e komponentit të TI në ASK përmes një konsulenti të TI-ve (në periudhë 3 muajshe) duke filluar nga mesi i muajit janar 2013.

UNICEF do të mbështesë ASK-në në zhvillimin e Fletushkave mbi politikat në Kosovë dhe rezultatet e regjistrimit të popullsisë lidhur me një mori të temave të ndryshme.

Realizimi i CensusInfo për shpërndarjen e rezultateve të regjistrimit të popullsisë përmes platformës online si dhe versionit desktop, të gjitha keto, si pjesë e standardizimit të përgjithshëm të të dhënave të ASK-së dhe të zhvillimit të metadatave.

5. SFIDAT

Një ndër sfidat kryesore të ASK-së në vitin 2013 është mungesa e buxhetit dhe mungesa e stafit.

Po ashtu sfidat tjera me të cilat pritet të ballafaqohet ASK janë:

- zbatimin e planit të riorganizimit të ASK-së
- zbatimin e programit të statistikave zyrtare (PSZ)
- përmirësimin e vazhdueshëm të dhënave statistikore
- krijimin e një sistemi unik statistikor të TI-së;
- realizimin e projektit të regjistrimit të bujqësisë
- zbatimin e kornizës së vlerësimit të performancës të PVSZ
- kalimi në nomenklaturën e aktiviteteve ekonomike NACE Rev. 2
- kuadri i burimit të të dhënave ende i pamjaftueshëm dhe mungesa e resurseve humane evidente. Kontrata e SIDA-ës me praktikantët e ASK-së ka përfunduar.
- gjetja e burimeve financiare për vazhdimin e anketës së fuqisë punëtore (LFS)
- publikimi i botimit “Llogaritë ekonomike ne bujqësi 2010-2011”. Mungesa e stafit.
- harmonizimi i statistikave në mes të ASK-së dhe ministrive që janë prodhuese të statistikave
- fillimi i projektit IPA 2011 (MB) - Programi i bashkëpunimit statistikor me shumëperfitues IPA 2011

6. SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE & QASJA

- Lançimi i CensusInfo databazës në web-faqen e ASK-se me të dhënat e regjistrimit të popullsisë 2011.
- Ofrimi i të dhënave statistikore në web-faqen e ASK-së në formatin excel për të gjitha departamentet statistikore.

Më poshtë është kalendari i publikimeve 2013.

Kalendari i Publikimeve 2013		
janar		
09 janar 2013	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Nëntor 2012)
15 janar 2013	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Dhjetor 2012)
30 janar 2013	Buletini Tremujor	(Tetor - Dhjetor 2012)
31 janar 2013	Vlerësimi i Popullsisë	2011
shkurt		
05 shkurt 2013	Statistikat e Transportit	TM4/2012
08 shkurt 2013	Repertori stat. mbi ndër. Ekon. në Kosovë	TM4/2012
12 shkurt 2013	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Dhjetor 2012)
14 shkurt 2013	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Janar 2013)
15 shkurt 2013	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në bujqësi	TM4/2012
19 shkurt 2013	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në bujqësi	TM4/2012
20 shkurt 2013	Statistikat e Mirëqenies Sociale	2012
22 shkurt 2013	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në bujqësi	2005-2012
25 shkurt 2013	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në bujqësi	2005-2012
mars		
08 mars 2013	Gratë dhe Burrat në Kosovë	2010-2011
13 mars 2013	Statistikat e Hotelerisë	TM4/2012
14 mars 2013	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Janar 2013)
15 mars 2013	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Shkurt 2013)
19 mars 2013	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM4/2012
22 mars 2013	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM4/2012
27 mars 2013	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM4/2012
28 mars 2013	Vlerësimi i Popullsisë	2012
prill		
15 prill 2013	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Mars 2013)
16 prill 2013	Të dhënat kryesore mbi vendbanimet e Kosovës	
17 prill 2013	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Shkurt 2013)
25 prill 2013	Të dhënat kryesore demografike	
30 prill 2013	Buletini Tremujor	(Janar-Mars 2013)
maj		
06 maj 2013	Statistikat e Transportit	TM1/2013

08 maj 2013	Statistikat e Mirëqenies Sociale	TM1/2013
09 maj 2013	Të dhënat kryesore socio-ekonomike	
13 maj 2013	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Prill 2013)
14 maj 2013	Repertori stat. mbi ndër. Ekon. në Kosovë	TM1/2013
14 maj 2013	Të dhënat kryesore të Tregut të Punës	
15 maj 2013	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Mars 2013)
16 maj 2013	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në bujqësi	TM1/2013
17 maj 2013	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në bujqësi	TM1/2013
20 maj 2013	Anketa e Fuqisë Punëtore	2012
31 maj 2013	Kosova në Shifra	2012
qershor		
05 qershor 2013	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Prill 2013)
06 qershor 2013	Të dhënat kryesore të Bujqësisë	
10 qershor 2013	Disa Fakte mbi Mjedisin në Kosovë	2011-2012
11 qershor 2013	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare	2012
12 qershor 2013	Statistikat e Arsimit për Arsimin Fillor (6-11 vjeç)	2012-2013
13 qershor 2013	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Maj 2013)
14 qershor 2013	Statistikat e Hotelerisë	TM1/2013
17 qershor 2013	Lindjet në Kosovë	2012
18 qershor 2013	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM1/2013
20 qershor 2013	Llogaritë Qeveritare	2012
21 qershor 2013	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM1/2013
24 qershor 2013	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM1/2013
25 qershor 2013	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	2012
26 qershor 2013	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	2012
27 qershor 2013	Stat. e jurisprudencës për persona madhor	2012
28 qershor 2013	Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore	2012
korrik		
05 korrik 2013	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Maj 2013)
08 korrik 2013	Statistikat e Arsimit për parashkollor (3-6 vjeç)	2012-2013
10 korrik 2013	Vdekjet në Kosovë	2012
11 korrik 2013	Të dhënat kryesore të ekonomive familjare	
12 korrik 2013	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Qershor 2013)
18 korrik 2013	Kurorëzimet dhe Shkurorëzimet në Kosovë	2012
31 korrik 2013	Buletini Tremujor	(Prill - Qershor 2013)
gusht		
05 gusht 2013	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Qershor 2013)
06 gusht 2013	Statistikat e Transportit	TM2/2013
09 gusht 2013	Repertori stat. mbi ndër. Ekon. në Kosovë	TM2/2013

13 gusht 2013	Stat. për arsimin e ulët dhe të mesëm të lartë (15-19 vjeç)	2012-2013
14 gusht 2013	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Korrik 2013)
15 gusht 2013	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në bujqësi	TM2/2013
19 gusht 2013	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në bujqësi	TM2/2013
30 gusht 2013	Statistikat e Mirëqenies Sociale	TM2/2013
shtator		
04 shtator 2013	Të dhënat kryesore të Arsimit	
05 shtator 2013	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Korrik 2013)
12 shtator 2013	Statistikat e Hotelerisë	TM2/2013
13 shtator 2013	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Gusht 2013)
16 shtator 2013	Statistikat e Arsimit Universitar	2012-2013
17 shtator 2013	Statistikat e Varfërisë	
18 shtator 2013	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM2/2013
19 shtator 2013	Bruto Produkti Vendor – Qasja e Shpenzimeve	2012
20 shtator 2013	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM2/2013
25 shtator 2013	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM2/2013
26 shtator 2013	Të dhënat kryesore të ndërtesave dhe Banesave/Shtëpive	
27 shtator 2013	Stat. e jurisprudences për persona të mitur	2012
tetor		
04 tetor 2013	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Gusht 2013)
14 tetor 2013	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Shtator 2013)
17 tetor 2013	Statistikat e Kulturës	2012
25 tetor 2013	Atlasi statistikor	
30 tetor 2013	Statistikat e Mirëqenies Sociale	TM3/2013
31 tetor 2013	Buletini Tremujor	(Korrik - Shtator 2013)
nëntor		
04 nëntor 2013	Statistikat e Shëndetësisë	2012
05 nëntor 2013	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Shtator 2013)
06 nëntor 2013	Statistikat e Transportit	TM3/2013
07 nëntor 2013	Repertori stat. mbi ndër. Ekon. në Kosovë	TM3/2013
12 nëntor 2013	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Tetor 2013)
14 nëntor 2013	Statistikat e Sportit	2012
15 nëntor 2013	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në bujqësi	TM3/2013
19 nëntor 2013	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në bujqësi	TM3/2013
20 nëntor 2013	Statistikat e Arsimit	2012-2013
22 nëntor 2013	Të dhënat kryesore të Migrimit (Emigrim-Imigrim)	

29 nëntor 2013	Kalendari i Botimeve të ASK-së	2014
dhjetor		
05 dhjetor 2013	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Tetor 2013)
06 dhjetor 2013	Fletëpalosja e ASK-ës	
10 dhjetor 2013	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM3/2013
11 dhjetor 2013	Shkaqet e Vdekjeve në Kosovë	2012
12 dhjetor 2013	Statistikat e Hotelierisë	TM3/2013
13 dhjetor 2013	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Nëntor 2013)
16 dhjetor 2013	Anketa e Mbeturinave Industriale	2012
17 dhjetor 2013	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM3/2013
18 dhjetor 2013	Resultatet e Anketës Strukture të Ndërmarrjeve	2012
19 dhjetor 2013	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM3/2013
20 dhjetor 2013	Projeksionet Demografike	
23 dhjetor 2013	Klaendari i ASK-ës	2013
26 dhjetor 2013	Bruto Produkti Vendor- Qasja e Prodhimit	2012
27 dhjetor 2013	Anketa e Mbeturinave Komunale	2012
30 dhjetor 2013	Katalogu i Publikimeve të ASK-ës	2012

7. BUXHETI

Për periudhën e përmendur për këtë program 2013, MTEF ka paraparë që buxheti për ASK të jetë si në vijim:

Tabela 1: Buxheti për ASK 2013

Buxheti	2013 €
	MF *
Pagat	608 798
Mallërat dhe shërbimet	302 000
Shpenzimet kapitale	
Shpenzimet kosto	37 500
TOTAL:	948 298
Numri I punëtorëve	139

Shenim: Në 11 dhjetor 2012, u mar vendim që numri i stafit të ASK të rritej nga 134 në 139

Aneksi 1 - Organogrami i ASK nga Janari 2013

